



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj për informacion

E nderuar,

Në vijim të kërkesës suaj për informacion administruar pranë nesh me Nr.12619 Prot, datë 21.07.2021 dhe në kuadër të projektit që synon rritjen e përfshirjes politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve, për të cilën kërkon informacion për politikat e bashkisë për të rinjtë të grup moshës 15-29 vjeç, ju informojmë si më poshtë:

- Struktura përgjegjëse për politikat rinore është Sektori i Rinisë dhe i Sportit në Drejtorinë e Kulturës Arsimit Rinisë dhe Sportit.
- Në lidhje me Bordin Rinor apo Këshill rinor ka pasur tentativa për krijimin e tyre nga organizata të shoqërisë civile, por nuk janë konsoliduar, ndërsa tani jemi në përgatitjen e procedurave, bazuar në Ligjin “Për Rininë” për ngritjen e Këshillit Rinor Lokal, kjo nismë e fundit është ndërmarrë nga bashkia Shkodër, specifikisht Qendra Rinore “Atelie”.
- Bashkia Shkodër disponon Qendër Rinore Publike e cila quhet “Atelie”, hapësirë e sigurtw rinore për të rinjtë 15-29 vjeç, ku zhvillohen aktivitete të ndryshme, mbi arsimin, punësimin dhe sipërmarrjen rinore, trashëgiminw kulturore, artin, sportin, teatrin, muzikën, vullnetarizmin, çështjet sociale dhe shëndetësore, me metodologji të edukimit jo-formal, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal kombëtar dhe

ndërkombëtar. Qendra rinore wshtw pjesw e rrjetit tw 12 Qendrave Komunitare “Për Familje”, në të cilat ofrohen shërbime si:

- informim, orientim dhe këshillim,
 - shërbime në familje,
 - mbështetje psiko-sociale,
 - ndërhyrje e hershme
 - mbrojtje e fëmijëve
 - shërbime për fëmijën, të riun dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitet
 - shërbime lëvizëse, transferimi dhe implementimi i shërbimeve komunitare sociale, në lagje dhe njësi administrative të bashkisë Shkodër
 - shërbim për higjienën personale, kujdesin shëndetësor dhe edukim.
- Buxheti i planifikuar për Sektorin e Rinisë dhe Sportit përfshin të rinj të kësaj grup moshë. Ai përbën 4% të shumës totale të buxhetit.
 - Bashkia Shkodër është në proces të hartimit të politikave rinore “Planit të Veprimit Rinor Lokal”.
 - Të punësuar në Bashkinë Shkodër, ka mbi moshën 21, pasi është e lidhur me arsimin Bachelor. Përqindja e të rinjve të punësuar të moshës 21-29 vjeç është 10% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në administratë.
 - Bashkia Shkodër ka praktikë dialogun e strukturuar me të rinjtë, me grupimet dhe organizatat rinore për përmirësimin e shërbimeve dhe politikave rinore, përmirësimin e shërbimeve publike edhe konsultimin për buxhetin e bashkisë Shkodër, organizimin e aktiviteteve kulturore artistike etj.

- Në konsultimin e fundit online të draft Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023 i Bashkisë Shkodër 16 – 30 vjeç (41,1%); 31 – 45 vjeç (38,2%), 45 – 60 vjeç (15%), mbi 60 vjeç (5,8%). Përveç mekanizmit online të konsultimit i cili është më i lehtë dhe më i aksesueshëm për rininë, bashkia vazhdon dhe e përdor konsultimin në grup me rininë me grupe të ndryshme të interesit.
- Për konsultim: <https://buxheti.info/shkoder/>
(Në bazë të kategorive që ju klikoni do gjeni shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Voltana Ademi